

kërkoi informacion zyrtar nga Bashkia Tiranë dhe Zyra Vendore Arsimore Tiranë për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të fëmijëve në konstatim të plotësimit të të gjitha kushteve thelbësore, si në aspektin formal, ashtu dhe substancial, për t'u konsideruar në kompetencën e tij lëndore¹.

Në vlerësim të përgjigjeve zyrtare të institucioneve të sipërpërmendura AP-ja konstaton si vijon:

Nxënësit me inicialet A.L., dhe B.L., lindur në fshatin Zall-Dajt, Njësia Administrative Zall-Bastar në datën 10.9.2021 janë regjistruar në shkollën e mesme të bashkuar “Bahri Nela”, në klasën e 10-të. Në vlerësim të kushteve social-ekonomike të familjes së tyre, familja Luga trajtohet me ndihmë ekonomike dhe fëmijët kanë përfituar tekstet shkollore falas. Gjatë vitit shkollor 2021-2022, fëmijët nuk kanë frekuentuar sistematikisht procesin mësimor, konkretisht nga data 3.12.2021 e në vazhdim ata nuk janë paraqitur në shkollë. Mësuesja kujdestare dhe ish-drejtori i shkollës pohojnë se janë përpjekur disa herë të komunikojnë me prindërit e nxënësve, të cilët janë shprehur se fëmijët nuk kanë dëshirë të vijnë në shkollë dhe **nuk kanë adresuar asnjëherë problematikën e mosfrekuentimit të procesit mësimor për shkak të bullizimit apo ngacmimit në mjediset e shkollës** nga mësuesit apo nxënësit. **Nxënësit e sipërpërmendur janë përjashtuar nga shkolla si pasojë e plotësimit të numrit të mungesave**². Aktualisht, nxënësit janë regjistruar përsëri në shkollë në klasën e 10-të dhe vijnë rregullisht frekuentimin e procesit mësimor³.

Nxënësit me inicialet A.L., dhe B.L., janë fëmijë të komunitetit rom-egjiptian dhe **fëmijë në nevojë** (fëmijë të familjes së skemës së ndihmës ekonomike). Bazuar në dokumentacionin shkresor rezulton se situata në të cilën gjenden këta dy fëmijë është **relativisht e sigurt**, pasi nuk vuajnë nga dëmtime që kanë ardhur si rrjedhojë e abuzimit. Ndërkohë, në vlerësim të faktit të **“mosfrekuentimit të procesit mësimor nga ana e tyre”** ky konsiderohet si faktor rreziku që të dy fëmijët mund të bëhen pre e abuzimit, dhunës, neglizhimit apo shfrytëzimit, nëse nuk realizohet ndërhyrje nga strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

Në kushtet e sipërcituara në të cilën ndodhen dy fëmijët, mësuesi kujdestar së bashku me drejtuesin e institucionit arsimor duhet të identifikonin nxënësit me inicialet A.L., dhe B.L., si fëmijë në nevojë për mbrojtje. Ky identifikim është dhe një ndër hapat e procesit të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për

¹Shkresa zyrtare me nr.K5/I69-2prot., datë 13.12.2022 të institucionit të Avokatit të Popullit

² Në zbatim të nenit 75, kreu III për arimin e mesëm të lartë, pika 5 ...*nxënësit që mungon pa arsye 45 orë mësimore, përjashtohet nga shkolla për vitin mësimor*

³ Shkresa zyrtare me nr.6393/1prot., datë 23.12.2022 të Zyrës Vendore Arsimore Tiranë

mbrojtje⁴. Pas identifikimit të nxënësve në nevojë për mbrojtje, mësuesi kujdestar dhe drejtuesi i institucionit, si punonjës të institucioneve publike duhet të kryenin raportimin pranë njësisë arsimore vendore apo strukturave për mbrojtjen e fëmijës⁵.

Të gjitha hapat e sipërcitura, konkretisht identifikimi dhe referimi, si pjesë të procesit të menaxhimit të rastit të fëmijës në nevojë për mbrojtje do të mund të **parandalonin përjashtimin e tyre nga shkolla për vitin mësimor 2021-2022.**

Kjo do të shkonte edhe në drejtim të përmbushjes dhe të objektivave dhe treguesëve të *Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025*⁶, si një dokument i ri i politikave specifike për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në dritën e angazhimeve që vendi ynë ka marrë përsipër në rrugën e integritimit Evropian. Në masën “arsimi” të këtij plani, parashikohet se:

- incentivat si bursat apo kuotat e vecanta për të rinjtë romë dhe egjiptianë janë shumë të rëndësishme për një tranzicion efektiv të kalimit të tyre në të gjitha nivelet arsimore. Prandaj plani ka përfshirë masa që mbështesin **studentët romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë** dhe të lartë nëpërmjet ofrimit të bursave, reduktimit të tarifës së shkollimit dhe përjashtimit nga tarifa e pagesës për mbrojtjen e gjuhës së huaj, detyrues⁷.
- identifikimi dhe adresimi i nevojave të nxënësve që nuk janë regjistruar në arsimin e detyrueshëm, **nuk vijojnë rregullisht mësimin apo janë në rrezik braktisjeje** është gjithashtu pjesë e masave të planit. Synohet ngritja e grupeve të punës ndërsektoriale funksionale në 61 bashki dhe referimi i familjeve të këtyre fëmijëve në shërbimet e mbrojtjes sociale⁸.

Bazuar në përgjigjen zyrtare të Njësisë Administrative Zall-Bastar, konstatohet se Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës (PMF) ka filluar menaxhimin e rastit, pasi është referuar nga AP-ja. Veprimet e kryera nga PMF-ja për mbledhjen e informacionit janë si vijon:

⁴Bazuar nenin 6, të vendimit nr. 578, datë 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”

⁵ Bazuar në nenin 7, të vendimit nr. 578, datë 3.10.2018 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”

⁶ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701 datë 18.11.2021.

⁷ Objektiv i specifik 1: Arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore

⁸ Objektiv i specifik 2: Përkrahja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit, duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor për romët dhe egjiptianët.

- zhvillimi i takimeve me me drejtuesin dhe psikologin e shkollës “Bahri Nela” për rastin në fjalë;
- zhvillimi i takimit me prindërit e fëmijëve në banesën e tyre;
- zhvillimi i takimit me fëmijët në prani të psikologes së shkollës me miratimin e prindërve.

Në vlerësim të informacionit të mbledhur dhe kushteve të vështira social-ekonomike të familjes është hartuar Plani Individual i Mbrojtjes (PIM) së fëmijëve me inicialet A.L., dhe B.L., në të cilin po përmendim disa nga masat e përcaktuara si vijon:

- ofrimi i paketave ushqimore dhe higjienike, mjeteve shkollore dhe veshëmbathje nga qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”;
- frekuentimi i procesit mësimor nga fëmijët;
- këshillimi dhe mbikqyrja e fëmijëve në mjediset e shkollës nga psikologjia e shkollës etj⁹.

Për sa më sipër, AP-ja kërkoi informacion nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve (ASHDMF) e cila në zbatim të detyrimeve ligjore që ka, mund të kryente një hetim administrativ lidhur me konstatimet që AP-ja ka evidentuar si shkelje administrative në kuptim të ligjit nr.18/2017 (neni 67, pika 3), ku mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social shkollor kanë për detyrë të raportojnë çdo rast të dyshuar apo të ndodhur, abuzimi, neglizhimi apo shfrytëzimi të fëmijës në njësitë arsimore vendore ose strukturat për mbrojtjen e fëmijës¹⁰.

Në vlerësim të komunikimit zyrtar konstatohet se ASHDMF-ja është vënë në dijeni të rastit në fjalë nga AP-ja dhe ka referuar rastin për ndjekje pranë Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) në Njësinë Administrative Zall-Bastar, Bashkia Tiranë. Këtë informacion AP-ja e dispononte nga komunikimi zyrtar i kryer me Bashkinë Tiranë dhe ZVA-në që në fillim të nisjes së hetimit administrativ për rastin në fjalë. Veprimet nga strukturat përgjegjëse (PMF-ja dhe ZVA-ja) për mbrojtjen e fëmijës **janë ndërmarrë menjëherë pasi rasti është bërë publik dhe është referuar nga institucioni ynë**. ASHDMF-ja rezultoi të mos ketë kryer një hetim administrativ lidhur me mosveprimet e organeve përgjegjëse të strukturave arsimore dhe mbrojtjes së fëmijëve që patën sjellë cënimin e të drejtës së këtyre fëmijëve për arsim¹¹.

⁹ Shkresa zyrtare me nr.115/1 prot., datë 23.1.2023 të Njësisë Administrative Zall Bastar

¹⁰ Shkresa zyrtare me nr.K5/I69-4 prot., datë 11.1.2023 të institucionit të Avokatit të Popullit

¹¹ Shkresa zyrtare me nr.10/4 prot., datë 30.1.2023 të Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Përfundimet: Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje të ulëta të regjistrimit në shkollë, analfabetizmi dhe përfundimit të shkollës **krahasuar me mesataren kombëtare.** Rreth 40,3% e romëve dhe 12,7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërsa mesatarja kombëtare është vetëm 1,6%. Sipas UNICEF, 33,9% e popullsisë romë është nën 14 vjeç dhe për rrjedhojë duhet të ndjekë shkollën¹². Gjithsesi, shumë fëmijë nuk janë rregjistruar kurrë dhe përqindja e braktisjes së shkollës është e lartë. Një numër i madh nxënësish romë braktisin arsimin e detyruar jo vetëm si rezultat i qëndrimeve diskriminuese, mungesës së mbështjetjes dhe ngacmimeve në shkollë, por edhe për shkak të nevojës për të ndihmuar prindërit e tyre në aktivitete që gjenerojnë të ardhura¹³. Sipas studimit të kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), bashkitë më të prekura nga braktisja e arsimit të detyrueshëm janë Tirana, Korça, Elbasani, Fieri, Durrësi dhe Berati¹⁴.

Ndonëse së fundmi ka patur një progres thuajse eksponencial në këtë drejtim, rritja e nivelit të regjistrimit dhe përfundimit të romëve të arsimit bazë në 90 përqind dhe shkalla e regjistrimit dhe përfundimit të romëve të **arsimit të mesëm të lartë në 50 përqind, mbetet një sfidë në Ballkanin Perëndimor.**

Problematikat e sipërcituara, por jo vetëm, angazhuan qeverinë, për miratimin e *Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025*¹⁵, duke synuar uljen e hendekut në aksesin ndaj shërbimeve publike cilësore në krahasim me shumicën e popullsisë. Ky plan veprimi ka shtatë sektorë prioritarë dhe vizioni i tij synon “Krijimin e kushteve të përshtatshme për arritjen e barazisë, pjesëmarrjes dhe përfshirjes së minoriteteve romë dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë, në të gjitha aspektet e jetës sociale, veçanërisht aksesin në arsim, punësim, strehim, shërbimet shëndetësore dhe sociale, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqenien, si dhe për të reduktuar hendekun socio-ekonomik dhe kulturor midis romëve dhe egjiptianëve nga njëra anë dhe pjesës tjetër të shoqërisë.” Plani është përafëruar me kujdes me Kuadrin e ri Strategjik të BE-së për Romët për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje 2020-2030.

AP-ja vlerëson punën e PMF-së dhe ZVA-së për veprimet e ndërmarra menjëherë, pasi rasti u bë publik në mediat *online*, referuar dhe nga AP-ja në përmbushje të nenit 51, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në drejtim të të identifikimit në mënyrë proaktive të rasteve të fëmijës

¹² UNICEF dhe Qendra e Studimeve Ekonomike dhe Shoqërore, *Hartëzimi i fëmijëve romë në Shqipëri*, 2011, http://www.sidalbania.org/Mapping_roma_children_english_may_5_2012.doc, f. 5.

¹³ Sipas studimit të OSFA-së, 4% e fëmijëve të moshës 6-17 vjeç janë të angazhuar në punë të ndryshme.

¹⁴ OSFA, *Censusi për banesat dhe popullatën romë në Shqipëri*, prill 2014, www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf

¹⁵ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701 datë 18.11.2021.

në rrezik dhe në nevojë për mbrojtje, nëpërmjet komunikimit me profesionistë nga sektori i arsimit të cilët kanë kontakte me fëmijët. Por, nga hetimi administrativ i kryer për rastin në fjalë AP-ja konstaton se mosveprimet nga ana e punonjësve të sektorit të arsimit, për identifikimin dhe referimin e nxënësve me inicialet A.L., dhe B.L., fëmijë të komunitetit romë-egjiptian në nevojë (të cilët braktisën shkollën për vitin mësimor 2021-2022) ka pasqyruar qasje jo të barabartë në arsim për këta fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian duke rezultuar në humbjen e një viti shkollor¹⁶.

Për rastin në fjalë, mbështetur në pikat “1”, “2” dhe “3”, të nenit 62, të ligjit nr.18/2017, përcaktohen qartë përgjegjësitë e strukturës së mbrojtjes së fëmijës dhe strukturave të tjera në nivel vendor, si: zyrës arsimore të qytetit dhe shërbimeve sociale në bashkinë Tiranë, për të mundësuar mbrojtjen e fëmijës, në veçanti të fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian.

Strukturat e mbrojtjes së fëmijës, bazuar në interesin më të lartë të tij, kanë të drejtë të kenë akses në institucionet e edukimit me qëllim që të verifikojnë situatën e fëmijëve romë-egjiptianë dhe fëmijëve në nevojë (fëmijët e familjeve përfituese të skemë së ndihmës ekonomike) që vazhdojnë procesin e edukimit për të identifikuar nëse kanë nevojë për mbrojtje apo jo.

Bazuar në legjislacionin e sipërcituar dhe në masat e parashikuara në Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 AP-ja konstaton se nuk është kryer identifikimi dhe adresimi i nevojave të nxënësve me inicialet A.L., dhe B.L., që nuk vijonin rregullisht mësimin dhe referimin e familjes të këtyre fëmijëve në shërbimet e mbrojtjes sociale¹⁷.

Gjithashtu, këta nxënës kanë përfitur vetëm librat falas për të mundësuar aksesin e tyre në arsim, por nuk kanë përfitur dhënie të bursës financiare për nxënës romë dhe egjiptianë që ndjekin gjimnazin (klasa e 10-të) bazuar në vendimin nr. 666, datë 10.10. 2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënës të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, AP-ja kërkon, që në zbatim të detyrimeve ligjore që Agjencia ka, të kryhet një hetim administrativ lidhur me konstatimet që AP-ja ka evidentuar si

¹⁶ bazuar në masat e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 që ka si objekt kryesor nxitjen e integritetit të romëve dhe egjiptianëve

¹⁷ Objektivi specifik 2: Përkrahja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit, duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor për romët dhe egjiptianët

shkelje administrative në kuptim të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 21, të ligjit nr.8454/1999, AP-ja,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave për identifikimin dhe adresimin e nevojave të nxënësve romë-egjiptianë që, nuk vijojnë rregullisht mësimin apo janë në rrezik braktisje nga strukturat arsimore dhe referimin e tyre pranë strukturave të mbrojtjes së fëmijëve.
- Marrjen e masave për dhënien e bursës financiare për nxënësit me inicialet A.L., dhe B.L., romë dhe egjiptianë që ndjekin gjimnazin (klasa e 10-të), bazuar në vendimin e nr. 666, datë 10.10. 2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në instirucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
- Monitorimin në vijmësi të punës së strukturave shtetërore përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi dhe marrjen e masave konkrete nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, për vendosjen dhe ekzekutimin e sanksioneve administrative, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve ligjore nga këto struktura.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454/1999 organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtrimin e këtij rekomandimi!

K O M I S I O N E R

Olta ALIAJ